REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E KULTURËS

Nr.3778 prot Maliq, më 22.6.2026

PROJEKT VENDIM

PËR AKTIVITETIN KULTUROR « VERË DHE PORTOKALLE »

Në mbeshtetje të ligjit 139/2015 date 17.12.2015"Për vetëqeverisjen vendore " neni 54 "detyrat dhe kopetencat e Këshillit Bashkiak, neni 25 " Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese",ligjit 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 32 " përgatitja dhe miratimi i Buxheteve vendore " ,të ligjit Nr 68/2018 "Per financat e vetëqeverisjes vendore" neni 45 "Rishpërndarjen e fondeve buxhetore", të ligjit Nr 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026" , Udhëzimit plotësues nr 2 datë 14.01.2025"Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2026",mbështetur në vendimin Nr 148 datë 24.12.2025 të Këshillit Bashkiak Bashkia Maliq "Për miratimin e Buxhetit për vitin 2026", ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën", ligjit nr. 25/2014 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën" dhe VKM nr.1173, datë 6.11.2009 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e Qeverisjes Qëndrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura", kërkojmë nga ana juaj :

1- Miratimin për mbështetje finaciare prej 1.000.000 (një milion) lek,për aktivitetin artistik.
2- Miratimin e datës të aktivitetit 17 gusht 2026.
3- Marëveshja për realizimin e aktivitetit do të bëhet midis Bashkisë Maliq dhe operatorit Utilis.
4- Financimi i Projektit do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Kulturës.

Preventiv

LLoji I shpenzimit	Njësi	Çmim	Total
Aktore me role kryesore	10	100,000	1,000,000

DREJTORI I DREJTORISË

Dhora Shkëmbi

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E KULTURËS

Maliq më 27/6/2026

3778

RELACION

Për aktivitetin Artistik "VERË DHE PORTOKALLE"2026.

Me inicjim dhe nën kujdesin e veçantë të Kryetarit të Bashkisë Maliq Z.**GëzimTopçiu**, për ti dhënë jetë, gjallëri dhe kënaqësi publikut të gjërë të bashkisë, mendojmë që të zhvillojmë aktivitetin artistik, "VERË DHE PORTOKALLE" 2026.

"Verë dhe Portokalle" është një spektakël veror humoristik dhe argëtues me anë të të cilit ne kemi për qellim aktivizimin e jetës artistike dhe kulturore të qytetit .

Me realizimin e këtij spektakli, Bashkia dhe Qëndra Kulturore, do të sjellë për qytetin një mbrëmje të paharrueshme artistike me interpretimin e aktorëve më të dashur nga publiku i spektaklit "**Portokalli**". Të cilët me humorin e tyre, do të bëjnë të qeshim për një natë të tërë, me publikun qe do të jetë i pranishëm në shesh.

Gjithashtu gjatë mbrëmjes do të ketë edhe këngë nga këngëtarë të mirënjohur, dhe në fund për të mbyllur shfaqen korri i portokallisë do të këndojë të një himn, krijuar enkas për qytetin.

Në këtë natë festive, gjithashtu do tëjenë të mirëpritur të performojnë në skenën e spektaklit edhe artiste të talentuar të qytetit.(talente të rinj, këngëtarë, vallëtarë. Të cilët sigurisht janë përzgjedhur më pare në bashkëpunimet me bashkinë dhe qëndrën kulturore të qytetit në mënyrë që garantojnë cilësi).

Gjatë spektaklit është menduar që edhe publiku në shesh të bëhet pjesëmarrës, aktorët dhe moderatorët do të ftojnë në skenë njerëz të rastësishëm të cilët do të kenë mundësi të tregojnë histori humoristike të tyren apo të bëhen pjesëmarrës në numrat e humorit të parapërgatitur.

Në fund adhuruesit më të zjarrtë do të kenë mundësi të bëjnë foto me personazhet dhe aktorët e tyre të parapëlqyer.

Ky event do të jetë falas për publikun dhe do të performojë datën 17 Gusht 2026, në bulevardin "Rinia" të qytetit të Maliqit.

DREJTORI I DREJTORISË

Dhora **SHKEMBI**

ORGANIZATË JOFITIMPRURËSE
VENDIM I GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË NR.764 VENDIMI, DATË 18.10.2012
NIPT L23520791R

Përshkrim projekti

"Verë dhe Portokalle"

2026

"Verë dhe Portokalle" 2026 është një spektakël veror humoristik dhe argëtues me anë të së cilit Organizata Jofitimprrëse Utilis ka për qëllim aktivizimin e jetës artistike dhe kulturore të qytetit.

Me realizimin e këtij spektakli, Bashkitë e vendit, do të sjellin për qytetet e tyre një mbrëmje të paharrueshme artistike me interpretimin e aktorëve më të dashur nga publiku të spektaklit "Portokalli", të cilët me humorin e tyre , do të bëjnë të qeshi për një natë të tërë, gjithë publiku që do të jetë i pranishëm në shesh.

Gjithashtu gjatë mbrëmjes do të ketë edhe këngë nga këngëtarë të mirënjohur si dhe në fund për ta mbyllur shfaqjen korri i "Verë dhe Portokalle" do të këndojë një këngë të krijuar enkas për qytetin ky mbahet spektakli.

Në këtë natë festive, gjithashtu do të jenë të mirëpritur të performojnë në skenen e spektaklit edhe artistë të talentuar të qytetit, apo talente të rinj, këngëtarë, vallëtarë. *(të cilët sigurisht do të jenë përzgjedhur më parë në bashkëpunim me bashkinë apo qendrën kulturore të qytetit, në mënyrë që të garantojnë cilësi)*

Gjatë spektaklit është menduar që edhe publiku në shesh të bëhet pjesëmarrës, aktorët dhe moderatorët do të ftojnë në skenë njerëz të rastësishëm të cilët do të kenë dëshirë të tregojnë një histori humoristike të tyren apo edhe të bëhen pjesëmarrës në numrat e humorit të parapërgatitur.

Në fund adhuruesit më të zjarrtë do të kenë mundësinë të bëjnë foto me personazhet dhe aktorët e tyre të parapëlqyer.

Nga pikëpamja artistike, stafi i realizimit të këtij spektakli garanton një shfaqje shumë cilësore për publikun dhe gjithashtu edhe të turistëve që vijnë të vizitojnë qytetin dhe që

do të jenë të pranishëm atë natë në shesh. Një nate që do të mbetet gjatë në mendjen e qytetarëve të të gjitha moshave, pasi ky spektakël është i dashur dhe i përshtatshëm për të gjithë. Pra të gjithë do të mbeten të kënaqur.

Kushtet që duhen plotësuar nga Bashkia për realizimin dhe mbarëvajten :

1. Të marrë përsipër të ofrojë një hapësirë publike (shesh) të përmasave të mjaftueshme për realizimin e spektaklit "Verë dhe Portokalle" 2026. Vend për vendosjen e skenës, për vendosjen e sponsorëve që na shoqërojnë (për çadrat dhe banakët e tyre) dhe hapësirë për publikun, i cili e ndjek pa pagesë këtë shfaqje (ditën e realizimit të aktivitetit në shesh nuk duhet të ketë tregtarë të tjerë ambulantë, përveç sponsorave të eventit). Pjesëmarrja do të jetë e jashtëzakonshme (bazuar në eksperiencat e viteve të kaluara).
2. Furnizim me energji elektrike (tre fazor).
3. Sigurimin e territorit nga forca të Policisë Bashkiake apo qoftë edhe Policisë së Shtetit në raste se shihet e nevojshme deri në largimin e trupës së aktorëve nga vendi i realizimit të spektaklit.
4. Mbështetje financiare për realizimin e spektaklit "Verë dhe Portokalle" 2026.

Drejtor Projekti

Ilir Muhametaj

ORGANIZATË JOFITIMPRURËSE
VENDIM I GJYKATES SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË NR.764 VENDIMI, DATË 18.10.2012
NIPT L23520791R

Datë, 22 Prill 2026

Drejtuar : **Bashkisë Maliq**

Lënda : Kërkesë për financim aktiviteti kulturor

Të nderuar,

Duke Ju uruar fillimisht punë të mbarë na lejoni t`Ju informojmë se Organizata Jofitimprurëse UTILIS gjatë sezonit veror 2026 do të organizojë, sikurse edhe gjatë disa viteve të mëparshme, spektaklin me titull "Verë dhe Portokalle" një spekakël humoristik me trupën e aktorëve të spektaklit të mirënjohur "Portokalli".

Gjatë sezonit veror 2026 organizata po planifikon shfaqjen e këtij spektakli në disa qytete të Shqipërisë dhe për këtë arsye Ju kërkojmë që nga ana e Juaj të mbështetemi financiarisht me një buxhet prej 1.000.000 lekë.

Nëse kërkesa jonë do të mirëpritet nga ana e Juaj, parashikohet që ky spektakël të organizohet në qytetin Tuaj në datë 17 Gusht 2026.

Sa më sipër, që ky spektakël të realizohet edhe në qytetin Tuaj, Ju lutemi merrni në konsideratë kërkesën tonë për mbështetje, në mënyrë që publikut të Bashkisë Maliq ti dhurohet një mbrëmje argëtuese me plot humor.

Me falënderimet paraprake Ju përcjellim konsideratën më të lartë,

Sinqerisht,

Drejtues Projekti

Ilir Muhametaj